

## Biografia



Dardan Fusha lindi me 16 qershor 1981.

Ai kreu shkollën fillore dhe të mesme në vendlindjen e tij, në Podujevë. Në vitin 2006 diplomoi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Drejtimi Menaxhment dhe Informatikë, ndërsa në vitin 2010 kreu studimet Master për të Drejtën Financiare, në Institutin për Drejtësi dhe Financa, Departamenti për Financa, Universiteti Goethe në Frankfurt, Gjermani. Në vitin 2019 përfundoi Programin për Leadership në Përfshirjen Financiare në Universitetin Tufts – The Fletcher School, në Boston Massachusetts, SHBA.

Z. Fusha filloi punën si ndihmës mbikëqyrës bankar në Bankën Qendrore në vitin 2006. Më vonë u promovua në pozitën e analistit të lartë financiar dhe në vitin 2012 u caktua në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Rregullativës në Departamentin e Licencimit dhe Metodologjisë. Gjatë kësaj periudhe, z. Fusha luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për bankat. Në vitin 2017, u emërua Drejtor në Departamentin e Sistemit të Pagesave, në mbikëqyrjen e operacioneve të sistemit ndërbankar të pagesave dhe udhëheqjen e iniciativave dhe reformave kryesore rregullative në këtë fushë.

Ekspertiza e z. Fusha shtrihet edhe në rolin e tij si kryesues apo mbështetës në disa projekte të rëndësishme, të zhvilluara nga BQK me mbështetjen e Thesarit Amerikan, FMN-së BB-së, USAID, GIZ dhe organizata tjera ndërkombëtare, si adaptimi i Kornizës Rregullative për Kreditë Hipotekare Rezidenciale dhe Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, Mbrojtjen e Konsumatorit, Kornizës së Basel-it, Qeverisjes Korporative, përfshirë implementimin e Programit për Remitancat dhe Pagesat ende në proces, i financuar nga SECO në zbatim nga Banka Botërore, për avancimin e infrastrukturës ligjore dhe teknike. Gjithashtu, ka një rol kyç për Kosovën, në projektin e Komisionit Evropian për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, nën koordinimin e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, nën implementimin e Grupit të Bankës Botërore.

Gjatë periudhës 2013-2023 shërbeu si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme në përfaqësim të BQK-së. Gjithashtu, z. Fusha mban pozitën e Kryesuesit të Vendit për Komunitetin e Përdoruesve të SWIFT në Kosovë dhe koordinon punën e Këshillit Kombëtar të Pagesave, role këto në kuadër të cilave angazhohet në mënyrë aktive dhe

promovon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet akterëve të ndryshëm të industrisë së pagesave. Ky rol i mundëson përfshirjen dhe ndjekjen e afërt të zhvillimeve të reja dhe projekteve, si Pagesat e Shpejta, Skemat/sistemet e pagesave të BE-së të njohura si SEPA dhe TIPS, Parimet e BIS për infrastrukturë e tregut financiar PFMI, Valutat Digjitale të Bankave Qendrore, etj.

Përvoja, njohuritë dhe përfshirja e tij në këto iniciativa të rëndësishme, e vendosin z. Fusha në krye të vendosjes dhe ndikimit për përgatitjen e sistemeve të pagesave që sigurojnë avancim të pagesave, remitancave dhe modernizimit të infrastrukturës së tregut financiar. Kontributi dhe drejtimi i tij, mbështetur me përvojën e gjatë në sistemet e pagesave, si dhe mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, kanë vendosur z. Fusha si pozitë kyçe në sektorin financiar, për nxitjen e reformave të rëndësishme dhe fuqizimin e zhvillimit të shërbimeve financiare digjitale.

Pas rreth 17 viteve përvoje profesionale në BQK, përfshirë 11 vite përvojë menaxheriale, me 26 tetor 2023, me propozimin e Guvernatorit, është emëruar në pozitën e Zëvendësguvernatorit për Operacionet Bankare nga Bordi i BQK-së, për një mandat prej pesë viteve. Në këtë rolë z.Fusha shërben edhe si anëtar i Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

Është i martuar, baba i dy fëmijëve dhe jeton në Prishtinë.